



Prishtinë, 28.01.2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1102\_2019

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 16 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,
- Dispozitat e Nenit 7 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit,
- Kërkesën e KQKO për amendamentimin e Kodit të Standardeve Elektrike të datës 04 tetor 2017,

në seancën e mbajtur me datë 28.01.2019, nxori këtë:

## VENDIM

- I. **APROVOHET** amendamenti i dokumentit “Kodi i Standardeve Elektrike” të KOSTT Sh.a., si në shtojcë të këtij vendimi.

### Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 04.10.2017 ka pranuar kërkesën e KQKO për amendamentimin e dokumentit “Kodi i Standardeve Elektrike” të harmonizuar me legjislacionin në fuqi. Në kuadër të grupit të KQKO janë bërë këto ndryshime duke përfshirë përshtatjen e termave, përmirësime gjuhësore dhe rregullime të tekstit.
- o ZRRE ka dhënë komente gjatë periudhës së amendamentimit si pjesëmarrëse aktive në KQKO, e të cilat komente janë përfshirë në dokument.
- o Pas vlerësimit të kërkesës së KQKO për amendamentim, Bordi i ZRRE ka aprovuar amendamentimin e dokumentit “Kodi i Standardeve Elektrike”.
- o Të gjitha dispozitat tjera të dokumentit “Kodi i Standardeve Elektrike” do të mbesin në fuqi.
- o Dokumenti “Kodi i Standardeve Elektrike” ver. 1.3 shfuqizon dokumentin “Kodi i Standardeve Elektrike” ver. 1.2.



- II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

*Shtojcë:* Dokumenti "Kodi i Standardeve Elektrike" i amendamentuar.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

**Bordi i ZRRE-së**

Arsim Janova, u.d. kryesuesit

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar